



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:109922

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792698

KPPP.nr.2217/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “INEX Petrol” SH.P.K., me NUI: 811233056, me seli në rr. “Dëshmorët e Lirisë”, në Kaçanik, kundër debitorit DPH. “Art Caffè”, me NUI: 811235995, me seli në rr. “Ismail Raka”, në Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.304/2019 të datës 18.12.2019, të Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 06.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit DPH. “Art Caffè”, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.304/2019 të datës 18.12.2019 i Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.304/2019 të datës 18.12.2019, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 0103/15-D të datës 01.03.2015; Faturës Nr. 0505/15-D të datës 05.05.2015; Faturës Nr. 0206/15-D të datës 02.06.2015 dhe Faturës Nr. 2506/15-D të datës 25.06.2015; duke obliguar debitorin që t’i paguajë kreditorit borxhin kryesor në vlerën prej 20,287.44 €, si rezultat i mos pagesës së faturave të lartcekura, me kamatëvonesë prej 8 % në vit, ashtu që të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të përmbartuesit privat, ose përmes zbatimit të përmbartimit me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve

të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, ku ndër të tjerash ka deklaruar se faturat e lartcekura nuk përmbajnë titull përmbarimor, për shkak se të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe për më tepër këto fatura debitori nuk i janë paraqitur asnjëherë, ndërsa paragonat-fletëdërgesat nuk lidhen me faturat e paraqitura. Më tutje ka shtuar se të gjitha detyrimet ndaj kreditorit i ka përmbushur, por edhe sikur të kishin ekzistuar këto detyrime, të njëjtat janë parashkruar. Në fund ka shtuar se pretendimi i kreditorit se është bërë konfirmimi i gjendjes në mes të palëve e njëjta është manipuluar, ngase nuk është nënshkruar dhe nuk përmban vulën e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të detyrohet kreditori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke përfshirë edhe përpilimin e prapësimit në shumën prej 208.00 € konform TOAK.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se faturat e bashkëngjitura kanë bazë ligjore përmes fletëdërgesave të mallrave të ndryshme të pranuar nga debitori. Më tutje ka deklaruar se palët me datë 02.09.2019 kanë konfirmuar detyrimet të cilat debitori i ka ndaj kreditorit dhe se pala debitore ka qenë i njoftuar se i njëjti gjendet në vonesë për këtë borxh dhe se në rast të mos përmbushjes së obligimit, kreditori do të vazhdojë me procedurën e përmbarimit. Ka theksuar se debitori nuk ka arritur të bashkëngjij ndonjë provë rreth pagesës së këtyre faturave. Në lidhje me pretendimet e debitorit se kërkesa e këtyre faturave është parashkruar, e njëjta nuk qëndron, për shkak se palët kanë përtërirë marrëveshjen e tyre, dhe se debitori me datën 10.04.2018 ka realizuar një shumë të pagesave në bazë të faturave të krijuar.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.136/18 të datës 13.02.2020 e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.382/2022 të datës 31.08.2022 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka prishur aktvendimin PPP.nr.136/18 të datës 13.02.2020 të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, gjykata pas vlerësimit të faturës kontestuese dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077), ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit e cila rrjedhë nga Fatura Nr. 0103/15-D e datës 01.03.2015; Fatura Nr. 0505/15-D e datës 05.05.2015; Fatura Nr. 0206/15-D e datës 02.06.2015 dhe Fatura Nr. 2506/15-D e datës 25.06.2015, janë parashkruar.

Me dispozitën e lartcekur të nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të nenit 355 parashihet se: 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të kërkesës për çdo dërgim të mallit, pune apo shërbimi të kryer, rezulton se kërkesa e kreditorit sipas Faturës Nr. 0103/15-D të datës 01.03.2015; Faturës Nr. 0505/15-D të datës 05.05.2015; Faturës Nr. 0206/15-D të datës 02.06.2015 dhe Faturës Nr. 2506/15-D të datës 25.06.2015; janë parashkruar në kuptim të nenit 355 paragrafi 2 të LMD-së, pasi propozimi i kreditorit për përmbartim është parashtruar me datë 18.12.2019, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të lartcekura kanë kaluar më tepër se 3 (tre) vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë.

Gjykata po ashtu shqyrtoi edhe çështjen e ndërprerjes së parashkrimit të kërkesës dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit sipas konfirmimit të gjendjes ndërmjet partnerëve të datës 02.09.2019 dhe gjeti se nga kjo marrëveshje, nuk mund të vërtetohet se debitori ka pranuar borxhin sipas faturave kontestuese, meqenëse në këtë marrëveshje nuk janë specifikuar fare

faturat dhe detyrimet për të cilat është iniciuar kjo procedurë përmbarimore, andaj gjykata vlerëson se një pretendim i tillë nga ana e kreditorit nuk gjen mbështetje ligjore.

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2217/22, datë 06.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.